



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:121338
Datë: 22.10.2024
Numri i dokumentit: 06331445

A.nr.1476/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Rexhep Gashi dhe me zyrtaren ligjore Asliha Fejzullahu, si procesmbajtëse, në konfliktin administrativ të paditëses M. G. nga fshati N..., Komuna e Kaçanikut, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson vajza e saj A. G. me adresë të vendbanimit të njëjtë, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve, duke vendosur lidhur me padinë e paditëses për anulimin e vendimit të datës 26.04.2022, për shkak të mos njohjes të së drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i parë, vlera e kontestit 8,100.00€, pas mbajtjes të seancës të shqyrtimit kryesor-publik, në prani paditëses dhe të autorizuarës së saj dhe në mungesë të përfaqësueses ligjore të paditurës-Ministrisë së Drejtësisë-Avokaturës Shtetërore, me datë 07.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET NË TËRËSI E BAZUAR** kërkesëpadia e paditëses M. G. nga fshati N..., Komuna e Kaçanikut, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson vajza e saj A. G. me adresë të vendbanimit të njëjtë.
- II. **ANULOHET** vendimi i datës 26.04.2022 i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve dhe paditëses M. G. nga fshati N..., Komuna e Kaçanikut i njihet e drejta në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë nga data 05.07.2020 e deri me datë 05.07.2023, kur e paditura i ka njohur këtë të drejtë paditëses me vendimin e datës 20.10.2023.
- III. **OBLIGOHET** e paditura Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, që paditëses M. G. nga fshati N..., Komuna e Kaçanikut, t'ia paguaj në mënyrë retroaktive diferencën në mes të kompensimit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë dhe të grupit të dytë nga data 05.07.2020 e deri me datën 05.07.2023, në shumën mujore prej 225€ apo në shumë të përgjithshme për 36 muaj prej 8,100.00€, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.
- IV. Ky aktgjykim e zëvendëson vendimin e datës 26.04.2022 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve.
- V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Ar sy e t i m

Me vendimin e kontestuar të datës 26.04.2022, e paditura Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve-organi i shkallës së dytë, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses për njohjen e së drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë, duke konfirmuar vendimin e organit të shkallës së parë të datës 19.08.2020, me të cilin vendim paditëses i është vazhduar e drejta në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të dytë prej datës 05.07.2020, në shumë mujore prej 150€.

Paditësja e pa kënaqur me vendimin e kontestuar, me padinë e paraqitur në gjykatë me datë 14.06.2022, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve tani MPFT-DP, siç kuptohet nga padia për shkak se nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore dhe për shkak se nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i datës 26.04.2022 i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve si i kundërligjshëm dhe që të miratohet kërkesa e paditëses për njohjen e të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik në grupin e parë, dhe po ashtu ti njihet e drejta në kujdestar personal, kjo nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Tutje në padi është parashtruar se organi i shkallës së dytë, gjatë shqyrtimit dhe vendosjes përkitazi me ankesën e paditëses, nuk ka vepruar në harmoni me dispozitat ligjore, përkatësisht nenin 7 par.1 dhe 2 të Ligjit nr.05/L-067, për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe nenit 5 par.1.2 dhe 1.3, si dhe nenit 6 par.1.2 të Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funksionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Është theksuar se me rastin e marrjes së këtij vendimi, organi i shkallës së dytë, përkatësisht komisioni vlerësues e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike e cila konsiston në faktin, se sipas të gjitha raporteve mjekësore, por edhe sipas gjendjen reale faktike, është konstatuar se aplikuesja është person me pasoja të përhershme dhe të plota, ka humbje të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe është person që bënë pjesë në pacientët e grupit të parë.

Përgjatë seancave gjyqësore, paditësja dhe autorizuara e saj ka deklaruar se vet e paditura me vendimin e datës 20.10.2023, në ri vlerësim paditëses i ka vazhduar të drejtën në kompensim për persona Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë nga data 05.07.2023. Ka cekur se mbetet në tërësi pran padisë dhe kërkesëpadisë, duke e njoftuar gjykatën se e kemi pranuar ekspertizën mjekësore të mjekeve specialist të datës 12.09.2024. Ka shtuar se pas dëgjimit të ekspertit mjekësor Dr. A. Sh., bëjmë rregullimin e padisë në kuptimin subjektiv dhe objektiv, ashtu që i propozojmë gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin anulohet vendimi i kontestuar i të paditurës MFPT-DP i datës 26.04.2022 dhe paditëses nga data 05.07.2020 i njihet e drejta në kompensim për personat paraplegjikë të grupit të parë deri me datë 05.07.2023, kur e paditura i ka njohur këtë të drejtë paditëses me vendimin e datës 20.10.2023, si dhe të obligohet e paditura MFPT-DP, që paditëses në mënyrë retroaktive t'ia kompensoj diferencën në mes të kompensimit për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë dhe të grupit të dytë nga data 05.07.2020 e deri me datën 05.07.2023, në shumën mujore prej 225€, apo në shumë të përgjithshme për 36 muaj prej 8,100.00€.

E paditura MPFT-DP, përmes përfaqësues ligjore-Ministrisë së Drejtësisë Avokaturës Shtetërore, në përgjigjen në padi të datës 24.11.2022, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë e paditëses si të pabazuar. Ka theksuar se paditësja ka parashtruar kërkesë për njohjen e të drejtës në pension të personave me aftësi të kufizuar, si një prej kandidatëve të mundshëm për zgjedhjen në realizimin e të drejtës në kompensim për Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Ka shtuar se Komisioni i ekspertëve mjekësor të lëmvive përkatëse, me rastin e vlerësimit nëse aplikant i plotëson kushtet për fitimin dhe shfrytëzimin e pensionit me aftësi të kufizuar ka konstatuar se kandidati-paditësja nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues i pensionit/të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Sipas të paditurës Këshilli i Ankesave për Pensione me Aftësi të Kufizuar i ka shqyrtuar shkresat e lëndës,

dokumentacionin mjekësor i cili gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit mjekësor të shkallës së parë, dhe ka konstatuar se paditësja nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues i këtij kompensimi në harmoni me dispozitat ligjore. Andaj e paditura i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të pa bazuar dhe që të lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.10.2024, ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ komfor nenit 41 të LKA-së, në mungesë të përfaqësues ligjore të paditurës-Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, respektivisht Ministrisë së Drejtësisë-Avokaturës Shtetërore, për arsye se, e njëjta edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt nuk ka prezantuar në seancë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. (Provë: Fletë dërgesa për dorëzim personal e datës 27.09.2024).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 07.10.2024, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka administruar provat relevante dhe atë: Vendimin e MPMS-së të dt.19.08.2020, Raportet konziliarë për përcjellës për paditësen të datës 13.01.2022, 10.06.2021, 14.11.2019, Raportet mjekësore për paditësen të datës 05.11.2019, 01.06.2017, 02.06.2017, Vendimin e MFPT-së të datës 26.04.2022, Ankesën e datës 04.02.2022, Ekspertizën mjekësore të datës 12.09.2024, Vendimin e MPMS-së për paditësen të dt.17.01.2018, Formularin e Komisionit mjekësor të paditurës për paditësen, Vendimin e MFPT-së të dt.20.10.2023.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 44 të LKA-së, ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit kontestues, në drejtim të thënieve në padi, thënieve në përgjigje në padi, deklarimeve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, për këto arsye:

Nga provat shkresore të administruara në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ, gjykata gjeti që në procedurë të ri vlerësimi e paditura-organi i shkallës së parë me vendimin e datës 19.08.2020, i ka vazhduar këtu paditëses të drejtën në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të dytë prej datës 05.07.2020, në shumën mujore prej 150€, për periudhë tri vjeçare. Paditësja e pa kënaqur me këtë vendim, me datës 04.02.2020, ka parashtruar ankesë në organin e shkallës së dytë-ankimor të paditëses, ankesë kjo e cila është refuzuar me vendimin e datës 26.04.2022, nga e paditura dhe është konfirmuar vendimi i shkallës së parë i datës 19.08.2020. E paditura, në arsyetim të vendimit të kontestuar ka theksuar se pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave në lëndë, pretendimeve ankimore, provave materiale mjekësore të bashkangjitura, në seancën e mbajtur me datë 15.04.2022, nga mjekë specialist të lëmisë përkatëse, që konstatuar që ankesa nuk është në harmoni me pikën 1 të nenit 8 të Ligjit nr.05/L-067, prandaj ankesa refuzohet si e pa bazuar, derisa mbetet në fuqi vendimi i mëparshëm.

Nga raportet konziliar për përcjellës të datave 13.01.2022, 10.06.2021 dhe 14.11.2019, të lëshuar nga QKUK-Klinika e Neurologjisë, rezulton se sipas këtyre tri raporteve paditësja është vlerësuar se bënë pjesë tek pacientët e grupit të parë, ku hyjnë personat me pasoja të përhershme dhe të plota, humbje të plotë të ndjeshmerisë së ekstremiteteve, me inkotenc alvi et urinare.

Nga vendimi i të paditurës me nr.1108 i datës 20.10.2023, gjykata e ka konstaton faktin se e paditura në procedurë të ri vlerësimi i ka njohur paditëses të drejtën për kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik tani të Grupit të Parë prej datës 05.07.2023, në shumë mujore prej 375€, duke përcaktuar se rivlerësimi do të bëhet pas 5 viteve. Në këtë vendim është dhënë arsyetimi se me vendimin e më hershëm, ju keni qenë përfitues i kompensimit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe në procedurë të ri vlerësimi, Komisioni Mjekësor i përbërë nga mjekë specialistë të lëmise përkatëse me dt.12.10.2023, ka shqyrtuar përsëri shkresat e lëndës lidhur me gjendjen shëndetësore të të lartcekurit dhe në kuptim të pikës

2 të nenit 7 të Ligjit nr.05/L-067, ka konstatuar që janë plotësuar kushtet ligjore për vazhdimin e të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë.

Me qëllim të vërtetimit të drejt dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë konflikt administrativ, përkatësisht se cilit grup të personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik i ka takuar paditësja nga data 05.07.2020 e deri me datë 05.07.2023, gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 22.07.2024, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore. Me aktvendimin e datës 19.08.2024, gjykata ka caktuar ekspertët mjekësor Dr.A. Sh.-Neurolog, Dr. L. S.-Urolog dhe Dr.N. A.-Fiziatër për ta kryer ekspertizë mjekësore. Ekspertët mjekësore në ekspertizën mjekësore të datës 12.09.2024, kanë dhënë përfundimin sipas të cilit në bazë ekzaminimit të drejtpërdrejt, shqyrtimit të dokumentacionit mjekësore, vlerësojmë se paditësja është me paraplegji (paralizë e gjymtyrëve të poshtme, me humbje të ndjeshmërisë dhe inkontinencë urinare). Andaj Komisioni i mjekëve ekspert, lidhur me pyetjen e gjykatës për periudhën nga 05.07.2020 e deri me datë 05.07.2023, duke u bazuar në raportet konziliare dhe specialistike të viteve respektive, vlerëson se paditësja ka qenë në të njëjtën gjendje shëndetësore, siç është tani.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.10.2024 eksperti mjekësor i pranishëm në seancë Dr.A. Sh. ka deklaruar se mbesim në tërësi pran ekspertizës mjekësore të dhënë me shkrim të datës 12.09.2024, në të cilën kemi vlerësuar që paditësja M. G. është me diagnozën paraplegji (me paralize të gjymtyrëve të poshtme, humbje të ndjeshmërisë së tyre dhe inkontinencë urinare). Ka cekur se lidhur me pyetjen e gjykatës për periudhën nga data 05.07.2020-05.07.2023, duke u bazuar në raportet konziliare dhe specialistike të viteve respektive, vlerësojmë që paditësja ka qenë në të njëjtën gjendje shëndetësore siç është tani, e që kjo i bie që paditësja ka qenë dhe është person Paraplegjikë i grupit të parë.

Në nenin 3, përkufizimet, par.1 pika 1.1 dhe 1.2 të Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik është përcaktuar “ *Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.1. Paraplegjikët – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme. 1.2. Tetraplegjikët – ose (kuadriplegjikët) – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme*”. Në vazhdim në nenin 7 par.1 dhe 2 të Ligjit nr.05/L-067 parashihet që “1. Përfituesit e këtij ligji, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar, bazuar në pagën minimale në Kosovë, dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, sipas propozimit të MPMS. 2. Përfituesit e këtij ligji, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, të cilët kanë pasojë të përhershme dhe të plota në inkontinencë, përdorin medikamente në baza ditore, kanë humbje të ndjeshmërisë së plotë të ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të plagëve dekubitare marrin një shumë shtesë prej pesëdhjetë përqind (50%) të kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni”. Në nenin 8 par.1 të këtij ligji po ashtu është përcaktuar se “1. Përfituesve të këtij ligji u njihet e drejta për një kujdestar personal, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji”. Në paragrafin 2 të nenit 8 të ligjit të njëjtë thuhet se “Përfituesit e këtij ligji kanë të drejtën e zgjedhjes së kujdestarit të tyre”. Kurse në vazhdim në nenin 9 par.1 parashihet se “E drejta në kompensim të përfituesve të këtij ligji, si dhe të kujdestarit personal të tyre, realizohet nga dita e parashtrimit të kërkesës, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe”, përderisa në paragrafin 3 të nenit 9 të ligjit përcaktohet se “3. PAGESA BËHET ÇDO MUAJ NGA DEPARTAMENTI PËR PENSIONE NË KUADËR TË MPMS”. Në nenin 5 par.1 pikat 1.1-1.7 të Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, parashihet se. “1. Komisioni vlerësues ka këto funksione dhe përgjegjësi: 1.1. Ekzaminimin e parashtruesit të kërkesës; 1.2. Vlerësimin e grupimit dhe nevojave sociale të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, e cila bëhet duke u bazuar në dokumentet mjekësore, mendimin konziliar nga Klinika e Neurologjisë-QKUK, si dhe ekzaminimit nga ana e Komisionit Vlerësues; 1.3. Përfituesit e grupit të parë

janë persona me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve; 1.4. Përfituesit e grupit të dytë janë persona që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve; 1.5. Përcaktimin e nevojës për edukim dhe arsimin; 1.6. Përcaktimin e nevojës për rehabilitim; 1.7. Përcaktimin e nevojës për kujdestar personal”.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë cekur më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar në ligj dhe fakte. Nga provat e administruara gjatë kësaj procedure të konfliktit administrative sidomos nga ekspertiza mjekësore e datës 12.09.2024 e ekspertëve mjekësor specialist Dr.A. Sh.-Neurolog, Dr.L. S.-Urolog dhe Dr.N. A.-Fiziatër, të cilës gjykata ja fali besimin në tërësi, sepse e njëjta ishte profesionale, e argumentuar mirë sipas vëllimit të përcaktuar për vërtetimin e fakteve vendimtare me rëndësi në këtë konflikt administrativ, si dhe bazuar në vendimin e të paditurës të datës 20.10.2023, nga ku vërtetohet se vet e paditura në procedurë të rivlerësimit i ka njohur/vazhduar të drejtën paditëses për kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të Grupit të parë prej datë 05.07.2023 në shumë mujore prej 375€, gjykata erdh në përfundim se në rastin konkret paditësja i plotëson kushtet ligjore nga neni 1 par.1 pika 1.1 dhe 1.2, dhe neni 7 dhe 8 të Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, si dhe neni 5 par. 1 pika 1.3 dhe 1.4 të Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, për të qenë përfitues i kompensimit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i parë për periudhën nga data 05.07.2020, kur e paditura me vendimin e datës 19.08.2020 paditëses i ka vazhduar të drejtën në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të dytë, për periudhe tri vjeçare, respektivisht deri me datë 05.07.2023, kur e paditura me vendimin e datës 20.10.2023, i ka vazhduar paditëses të drejtën në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë prej datës 05.07.2023, në shumë mujore prej 375€, andaj gjykata vendosi ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjykata konstaton se ekspertët mjekësore të cilët kanë analizuar dokumentacionin mjekësor të paditësit dhe kanë bërë ekzaminimin e drejtpërdrejt të paditëses kanë ardhur në konstatimin profesional se paditësja është me paraplegji (paralizë e gjymtyrëve të poshtme, me humbje të ndjeshmërisë dhe inkontinencë urinare) dhe se lidhur me pyetjen e gjykatës për periudhën nga data 05.07.2020-05.07.2023, duke u bazuar ne raportet konziliarë dhe specialistike të viteve respektive, vlerësojmë paditësja ka qenë në të njëjtën gjendje shëndetësore siç është tani, e që kjo i bie që paditësja ka qenë dhe është person Paraplegjik i grupit të parë.

Gjykata vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar të shkallës së dytë të datës 26.04.2022 dhe në vendimin e organit të shkallës së parë të datës 19.08.2020, se paditësja i plotëson kushtet për kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i dytë, nuk është i drejt, për shkak se, në rastin konkret nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike dhe nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore në fuqi, përkritazi me kushtet ligjore për njohjen e të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Kjo, sepse sipas vlerësimit të gjykatës e paditura kur i ka bërë vlerësim paditëses, përmes Komisionit Mjekësor i cili vepron në kuadër të paditurës, qoftë në vlerësimin në shkallë të parë me datë 17.08.2020, por edhe në vlerësimin në shkallë të dytë me datë 15.04.2022, nuk i është përmbajtur përgjegjësi të Komisionit Vlerësues të përcaktuara me nenin 5 të Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Në këtë aspekt gjykata thekson se e Komisioni Mjekësor i të paditurës vlerësimin për paditësen nuk e ka kryer në mënyrë të plotë, ngase nuk dihet se cilin nga dokumentacioni mjekësor e ka shqyrtuar dhe analizuar për paditësen, nuk dihet nëse është ekzaminuar paditësja, pastaj nuk ka dhënë konstatimin lidhur me nevojën për edukim dhe arsimim të përhershëm për paditësen, nuk ka përcaktuar

nëse paditësja ka nevojë për rehabilitim dhe për kujdestar personal, siç përcaktohet me nenin 5 par.1 pikat 1.1-1.7 të Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkzionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Gjykata vlerëson se formulari vlerësues për njohjen dhe statusin dhe të drejtat e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik i të paditurës, nuk është i hartuar konform Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkzionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, sepse siç shihet nga ku formulari vendimmarrjen lidhur me njohjen ose jo të statusit dhe të drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik e jep Komisioni Mjekësor, i cili nuk e ka këtë kompetencë sipas Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe Rregullores nr.07/2017. Në rastin konkret komisioni mjekësor ka dhënë rezultatin e vendimit duke rumbullakuar shenjen aprovim dhe grupi i dytë në formular, që gjë gjykata thekson se është në kundërshtim me kërkesat ligjore nga nenit 5 par.1 pikat 1.2, 1.5, 1.6, 1.7 dhe neni 7 pika 6 dhe 7 e Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkzionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Së këndejmi gjykata vë në theks se sipas paragrafit 6 dhe 7 të nenit 7 të Rregullores nr.07/2017, Komisioni Vlerësues i shqyrton lëndën, kurse Departamenti i Pensioneve pasi ta merr lëndën nga ky komision merr vendim për njohjen apo mos njohjen e statusit për kompensim financiar për personin Paraplegjik dhe Tetraplegjik, bazuar në vlerësimin e Komisionit Vlerësues.

Në vlerësimin e tërësishëm të çështjes, gjykata vlerëson se e paditësja i plotëson kushtet ligjore për të qenë përfitues i kompensimit nga grupi i parë i personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik për periudhën tri vjeçare nga data 05.07.2020 e deri me datë 05.07.2023, kur e paditura i ka njohur këtë të drejtë paditëses me vendimin e datës 20.10.2023, për arsye se, e njëjta siç kanë konstatuar mjekët specialist të cilët e kanë kryer ekspertizën mjekësore për paditësen, paditësja në këtë rast i plotëson kushtet për të qenë përfitues i grupit të parë të personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik për periudhën e lartcekur pasi që gjendja shëndetësore saj ka qenë e njëjtë me gjendjen shëndetësore të tanishme. Gjykata thekson se e paditura nuk e ka kundërshtuar ekspertizën mjekësore të datës 12.09.2024, dhe nuk ka propozuar nxjerrjen e ndonjë ekspertize tjetër mjekësore.

Duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar më lartë, gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditëses janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se e njëjta i plotëson kushtet ligjore për të qenë përfitues i kompensimit të personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i parë sipas nenit 7 dhe 8 të Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, për periudhën nga data 05.07.2020 e deri me datë 05.07.2023, andaj gjykata vendosi që krahas njohjes së kësaj të drejte paditëses në dispozitivin e II të aktgjykimit, që në dispozitivin III, ta detyroj të paditurën që paditëses, t'ia paguaj në mënyrë retroaktive diferencën në mes të kompensimit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë dhe të grupit të dytë nga data 05.07.2020 e deri me datën 05.07.2023, në shumën mujore prej 225€ apo në shumë të përgjithshme për 36 muaj prej 8,100.00€. (Gjykata thekson se kompensimi sipas vendimeve të vet paditurës të larcekura për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë është 375€ në muaj, kurse ky kompensim për grupin e dytë është 150€, e që diferenca në mes të këtyre dy grupeve është 225€, pasi që $375€ - 150€ = 225€$).

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe deklaratimet e palës së paditur të dhëna në përgjigjen në padi, përmes përfaqësues ligjore, por gjykata erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par.2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.1476/2022, datë 07.10.2024

G j y q t a r i
Rexhep Gashi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej **15 ditësh** nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.